


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN
BELEDIYESI

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN



MARRËVESHJE
PËR
SHKËPUTJEN E KONTRATËS PUBLIKE KORNIZË

Me titull: **“Furnizim me material botues”**
nr. të prokurimit GI 651 17 060 121
nr. Protokollit: **16-2747/17** të datës **20.01.2017** të lidhur

Ndërmjet

KOMUNËS SË GJILANIT SI AUTORITET KONTRAKTUES, të cilën e përfaqëson **Jehona Hyseni**, Zyrtare përgjegjëse e prokurimit

Dhe

KOMPANISË N.T “ATALANTA” nga GJILANI të cilën e përfaqëson **Nazim Mehmeti** drejtor

Gjilan, 11.04.2018

Hyseni

Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj marrëveshje është shkëputja e kontratës bazë me nr. të prokurimit GL 651-16-060-121 “Furnizim me material botues” nr. të protokollit 16-2747/17 të datës 20/01/2017 të lidhur ndërmjet **Komunës së Gjilanit** si Autoritet Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik **N.T.”Atalanta”** nga Gjilani.

Neni 2 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje mbështetet në dokumentet:

- 1.1. Kontratën me **Nr. të protokollimit 16-2747/17 të datës 20/01/2017,**
- 1.2. Nenin 20 - Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve,
- 1.3. Raportet- Imellat nga të gjitha Njësitë e Kërkesës,
- 1.4. **Konstatimet e nxjerra nga Autoriteti kontraktues nga mbikëqyerja e realizimit të projektit :**
 - 1.4.1. Se furnizimet për materiale botuese ka qenë shumë me vonesë e në të shumtën e rasteve nuk i'u është përgjigjur kërkesave nga njësitë kërkuese duke mos iu përmbajtur kushteve të paraparë me kontratë. **Kushteve të përgjithshme të kontratës në bazë të Nenit 10.2 dhe Nenit 20 dhe Kushteve të Veçanta të kontratës.**
 - 1.4.2. Gjatë kryerjes së furnizimeve në vazhdimësi ka pasur vërejtje nga njësit kërkuese lidhur me cilësinë e materialeve botuese dhe
 - 1.4.3. Sugjerimet e njësive të kërkuese janë se furnizimet janë krye me shumë vonesa dhe në pamundësi që të vazhdohet më tutje propozojnë që kjo kontratë të ndërpritet – shkëputet.

Neni 3 ANGAZHIMET, SPECIFIKIMET DHE OBLIGIMET E PALËVE

1. Palët në pajtim me kontratën bazë të furnizimit siç u cekë më lartë kanë ndërmarrë të gjitha veprimet **për shmangien e ndërprerjes së kontratës duke mbajtur takime dhe biseda por nuk kanë dhënë sukses.**
2. Duke pasur parasysh se sipas vlerësimeve të dhëna në raportet e Njësive kërkuese shihet se furnizimet të cilat kanë qenë lëndë e kësaj kontrate nuk janë kryer me rregull.

3. Operatori Ekonomik N.T "Atalanta" Rr. Iliria nr.2/3 nga Gjilani, me drejtor Nazim Mehmeti, ka paraqitur kërkesë për shkëputjen e kontratës me marrëveshje më datë 06.02.2018 pranë Zyrës së Autoritetit Kontraktues, Komunës së Gjilanit.
- 3.1 Operatori Ekonomik ka kërkuar që të i mundësohet ndërprerja e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me material botues "** me numër të prokurimit **GL 651 16 060 121**. Arsyeja e shkëputjes së kontratës është sëmundja e djalit të tij, për shkak të keqësimit të gjendjes shëndetësore dhe që kjo sëmundje kërkon shërim jashtë vendit, me këtë rast operatori ekonomik nuk mund të jetë në gjendje të i përmbush detyrat që dalin nga marrëveshja e kontratës së lart cekur dhe arsyet e vonesave për furnizime sipas kërkesave të Njësisë Kërkuese ka ndodhur për shkak të kujdesit dhe përkushtimit të gjendjes shëndetësore të djalit e që kjo vërtetohet edhe nga raportet mjekësore të dorëzuara nga Operatori Ekonomik tek Autoritetit Kontraktues si dhe dëshmit e poshtëshënuara:
- 3.2 Pjesë e kësaj marrëveshje për shkëputjen e kontratës do të jenë të gjitha raportet – imellat të dërguara nga Njësit Kërkuese – Drejtorit.
- 3.3 Raporti i Operatorit Ekonomik N.T "Atalanta", lidhur me mbarëvajtjen e punëve në bazë të Kontratës Publike Kornizë.
- 3.4 Kërkesa e Operatorit Ekonomik për shkëputjen e kontratës më datë 06.02.2018.
- 3.5 Raportet mjekësore të gjendjes shëndetësore të djalit të tij.
- 3.6 Kartela financiare e nxjerrur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për pagesat e kryera gjatë vitit 2017 dhe 2018.
- 3.7 Faturat e pagesave mbetur borxh nga Autoriteti Kontraktues për Operatorin Ekonomik për shërbimet e kryera,
- Fletëdërgesa Nr. 0012811 shuma 20 €,
 - Fletëdërgesa Nr. 0015910 shuma 4,80 €,
 - Fletëdërgesa Nr. 0015914 shuma 2,40,
 - Fletëdërgesa Nr. 0015911 shuma 1,80 €,
 - Fletëdërgesa Nr. 0015912 shuma 6 €,
 - Fletëdërgesa Nr. 0015913 shuma 4,50 € si dhe
- 3.8 Raporti i Shpenzimeve (borxhet) – Faturat e zgjedhura
- ID 15692 fatura 6/2017 DT.02.09.17 Kod.eko.13610 vlera 73.10 €,
 - ID 14832 fatura 10/2017 dt.05.17.17 Kod.eko.13610 vlera 4.50 €
 - ID 9866 fatura 1/1-2015 dt.09.29.15 Kod.eko vlera 674.00 €
- 3.9 Obligimet e Autoritetit Kontraktues ndaj Operatorit Ekonomik në bazë të fletëdërgesave të lartëshënuara janë gjithsej në shumën prej **791.1 €**

Neni 5

Me shkëputjen e kontratës bazë, palët nuk mund të kenë mëturje kurfarë pretendimi material financiar apo moral që rrjedh nga marrëveshja bazë dhe jashtë kësaj marrëveshje, po ashtu as nuk mundë ngritet kurfarë kontesti në gjykatë.

Neni 6

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.
2. Marrëveshja është hartuar në dy kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga një kopje.

**KOMUNËS SË GJILANIT- AUTORITET
KONTRAKTUES**


Jehona Hyseni, zyrtare përgjegjëse e
prokurimit.

Gjilan, 11.04.2018

**KOMPANISË N.N“ATALANTA” nga
GJILANI, e përfaqësuar**


Nazim Mehmeti, drejtor

Gjilan, 11.04.2018